

**AKT THEMELIMI**  
**I**  
**SHOQERISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“ MARINA SUITES ” sh.p.k.**

Në Durrës, sot më datë 26.02.2025 (dymijë e njëzet e pese), personi fizik:

**Z. . Mariglen Konesha**, atësia Kapllan, e lindur më 01.06.1996, në Diber dhe ne Durres, i identifikuar nëpërmjet ID me Nr. J60601135N, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar

Vendosi sa vijon:

**NENI 1**

Themelohet shoqëria tregtare : “ **MARINA SUITES**” Sh.p.k

Ortaku themelues i saj është:

a) **Z. . Mariglen Konesha 100%**

Shoqeria tregtare “ **MARINA SUITES**” Sh.p.k, do të jetë shoqëri me përgjegjesi të kufizuar.  
Emërtimi i shoqërisë do të jetë i stampuar dhe ne vulën e saj.

**NENI 2**

4.1 Selia e shoqërisë do të jetë në adresën: Durrës, Lagjja Nr. 1 Rruga “Taulantia”, Zona kadastrale 8512, numer pasurie 24/657-ND37.

**NENI 3**

Shoqëria e shtrin aktivitetin e saj ne dhenie dhoma me qera ditore.

**NENI 4**  
**Kapitali i shoqërisë**

1. Kapitali fillestar i shoqërisë është 100 lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë 100 % i kapitalit të shoqërisë **Mariglen Konesha** . :



2. Ortaku themelues **Mariglen Konesha** është zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 100 lekë, që përbën 100 % të kapitalit themeltarë të shoqërisë.

Shoqëria mund të ndryshojë kapitalin themeltar; Transferimi i kuotave kushtëzohet nga e drejta e parablerjes në favor të ortakëve të tjerë;

Po kështu transferimi i Kuotave bëhet sipas neneve 72; 73 ;74 ;75 dhe përgjithësisht siç parashihet në ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008. Të gjitha transferimet kanë efekt mbi shoqërinë që nga momenti i regjistrimit në librin e Ortakëve.

Ortaku ka të drejta pronësie mbi çdo lloj kapitali, mjeti xhiroje si dhe mbi çdo lloj pasurie tjetër të fituar në rrugë të ligjshme. Shoqëria përgjigjet vetëm me kapitalin e saj.

#### **NENI 5**

Kohëzgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë është me një afat të pacaktuar.

#### **NENI 6**

Shoqëria e zhvillon veprimtarinë e saj tregtare në përputhje të plotë me Legjislacionin Shqiptar në fuqi si dhe mbi bazën e këtij Akti Themelimi dhe Statutit të saj.

#### **NENI 7**

Pjesët e kapitalit janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie, në përputhje me ligjin dhe statutin.

#### **NENI 8**

Shoqëria “ **MARINA SUITES**” sh.p.k. krijohet për të ushtruar aktivitetin e saj konform objektit që do të jetë:

Veprimtaria e saj është dhenie dhoma me qera ditore

#### **NENI 9**

Me vendim të Asamblesë së Ortakëve, shoqëria mund të zgjerojë aktivitetin e saj tregtar dhe në drejtimet të tjera të cilat janë me interes për mbarëvajtjen e shoqërisë.

#### **NENI 10**

Me vendim të Asamblesë së ortakëve, shoqëria mund të zgjerohet duke pranuar një ose me shumë ortakë të tjerë, shtetas shqiptarë apo të huaj, ose të bashkohet me shoqëri tjetër tregtare si brenda vendit dhe jashtë saj.



#### NENI 11

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është Organi më i Lartë Drejtues dhe Vendimor i shoqërisë dhe ai ushtron të gjitha kompetencat që ligji " Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare " i njeh asamblesë së ortakëve që janë krijuar me ortakëri.

Ortakët mund t'ia delegojnë kompetencat një ose më shumë administratorëve të caktuar prej tyre ose dhe një personi fizik jashtë ortakërisë së shoqërisë.

#### NENI 12

Administratori i Shoqërisë,do të jetë:

**Zj Amarilda Konesha**, atësia Azem, i lindur më 20.08.2003, në Tirane dhe banues në Durrës, , e identifikuar nëpërmjet ID me Nr. K358200880, madhur dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Administratori i shoqërisë, **Zj Amarilda Konesha**, emërohet për një afat 5 (pesë) vjeçar nga data e nënshkrimit të këtij akti.

#### NENI 13

Ky Akt Themelimi hartohet në 3 kopje origjinale, me të njëjtën vlerë ligjore, një kopje depozitohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Ky akt u lexua dhe u kuptua nga nënshkruesi i cili deklaroi se akti është i rregullt tërësisht dhe në çdo paragraf në përputhje me vullnetin e lirë e të plotë të tij, jep pëlqimin për sa përmendet në akt dhe nënshkruan rregullisht në çdo faqe dhe emër, mbiemër dhe firmë në mbyllje të aktit.

#### ORTAKU THEMELUES I SHOQËRISË TREGTARE

**" MARINA SUITES" sh.p.k.**

Mariglen Konesha

